

TË DHËNA TAKSONOMIKE MBI PËRFAQËSUESIT E RENDIT ODONATA TË TAKUARA NË MJEDISËT E LIQENIT TË VIROIT NË RRETHIN E GJIROKASTRËS

TAXONOMIC DATA ABOUT ODONATA ORDER REPRESENTATIVES IN THE HABITATS OF VIROI LAKE IN THE REGION OF GJIROKASTRA

MARSELA ALIKAJ*, LAVDI HASANI

Departamenti i Biologjisë, Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Shqipëri

Email: alikajmarsela@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Studimi taksonomik mbi përfaqësuesit e rendit Odonata përbën sa një domosdoshmëri për sa i përket vlerave shkencore që sjell, aq edhe një vështirësi për sa i përket përvojës shqiptare në këtë drejtim.

Me anë të këtij studimi kemi dashur të japim një kontribut taksonomik të vlefshëm në drejtim të përfaqësuesve të këtij rendi, për zonën në studim, me origjinë nga paleozoiku, por të mbijetuara deri në ditët e sotme. Ky studim është i vetëm për këtë grup insektesh për Liqenin e Viroit dhe rrethin e Gjirokastrës. Studimi është bërë në dy periudha kohore, Maj – Shtator 2005 dhe Maj - Shtator të vitit 2008, në Liqenin e Viroit të rrethit të Gjirokastrës dhe në ujërrjedhësat rreth tij. Gjatë dy ekspeditave grumbullimi i Odonatave është bërë në brigjet e ujrave të rrjedhshëm e të ndenjtur të Liqenit të Viroit si habitatet më të frekuentuara prej tyre. Në përfundim të këtij studimi, i cili ka edhe vlera për plotësimin e të dhënave mbi biodiversitetin e zonës në studim, rezultoi se në habitatet e mara në vëzhgim u evidentuan 10 lloje Odonatash që u përkasin 6 familjeve dhe 9 gjinive.

Fjalët çelës: Rendi Odonata, studim taksonomik, liqeni i Viroit, Gjirokastrë.

ABSTRACT

Taxonomic study of Odonata order representatives is a necessity concerning the scientific value it involves, as well as a difficulty with regard to the Albanian experience in this aspect. Through this study we have attempted to give a useful taxonomic contribution to representatives of this order in the area under study, of Paleozoic origin, but surviving until today. The study of this insect order is a single for Viroi Lake and

Gjirokastra district. It has been carried out within two periods: May - September 2005 and May - September 2008, in the Lake of Viroi, in Gjirokastra district and its surroundings. During two expeditions, the collection of Odonata has been held in the coasts of running and stagnant waters of Viroi Lake, as their habitat. At the end of this study, which is valuable for the data completion of the biodiversity of the area under study, we reached the following conclusion: In the habitat that we observed there exist 10 odonata species belonging to 6 families and 9 genera.

HYRJE

Pilivesat (odonatat) janë një grup i vogël insektesh shumë të vjetër, që njihen me format arkaike, Meganizopterët, qysh nga Karboniferi në pyjet e nxehta e me lagështi të Laurentes (kontinent që në atë kohë shtrihej nga Kanadaja në Europën Lindore). Ato kanë pasur dimensione gjigande, por janë zhdukur gjatë Jurasikut. Në Permian janë shfaqur pilivesat me forma primitive koresponduese me Zigopterët, Anisopterët e Anizozigopterët. Disa specie pilivesash të periudhës së Terciarit kanë patur forma identike me ato që jetojnë sot. Pilivesat janë specie karnivore me aparat gojor primitiv të tipit brejtës. Në Europë njihen rreth 133 specie. Janë insekte kryesisht të dobishme që luajnë rol në pjalmimin e bimëve, në ruajtjen e biodiversitetit të arealeve duke siguruar vijueshmërinë e zinxhirëve ushqimorë. Përhapja gjeografike e këtyre llojeve, megjithëse përfaqësojnë forma nga më të vjetrat, është kozmopolite. Me vjetërsinë e tyre lidhet edhe mënyra e jetesës në stadiet larvare të tyre në sipërfaqe të ujrave të qeta dhe në fazat imago në mjediset me lagështi dhe hije.

Studimi ynë në lidhje me këtë grup insektesh (odonatat), u shtri në zonën e Liqenit të Viroit në rrethin e Gjirokastrës.

Zona e Viroit konsiderohet si një zonë me një biodiversitet të konsiderueshëm. Nga një studim i mëparshëm i kryer nga Departamenti i Biologjisë të Universitetit “E.Çabej” të Gjirokastrës, në këtë zonë, janë evidentuar rreth 38 lloje kafshësh vertebrorë, 62 lloje kafshësh invertebrorë dhe rreth 270 lloje gjallesash bimorë (në total 370 lloje).

Në drejtim të rendit Odonata, nga Departamenti i Biologjisë (Universiteti “E. Çabej”) ishte filluar një punë e tillë dhe kishte ngelur e pa finalizuar plotësisht. Me qëllim edhe përfundimin e kësaj pune të filluar dhe plotësimin e vlerave të mësipërme të biodiversitetit të zonës në fjalë ne ndërmorëm këtë studim të karakterit thjesht taksonomik pa u shtrirë në dinamikën e popullatave llojore gjë që mund të ngelet si objekt i punës tonë për të ardhmen.

MATERIALI DHE METODA

Gjatë periudhave Maj - Shtator 2005 e Maj - Shtator 2008 në territorin e Liqenit të Viroit në rrethin e Gjirokastrës kemi arritur të grumbullojmë, nëpërmjet 44 ditë ekspeditash kronologjike të realizuara në terren, një sasi të konsiderueshme prej 325 individë pilivesash që gjendeshin në këtë zonë. Grumbullimi i pilivesave (vetëm e formave adulte) është bërë me anë të rrjetave entomologjike (fig.1), në 6 stacione të paracaktuara (harta 1), e më pas ato janë vendosur në kavanoza qelqi me kapak për asfiksimin e tyre duke përdorur substanca toksike (kloroform ose alkool 60-70°).

Përcaktimi i stacion-grumbullimeve është bërë në bazë të këtyre kriterëve; popullimi i zonës nga bimësia dhe llojet e ujrave (të ndenjura apo të rrjedhshëm). Për të dhënat bio-ekologjike janë mbajtur shënime të hollësishme në terren, si dhe janë bërë mjaft foto të mjediseve ku janë mbledhur pilivesat.

Gjithë materiali i grumbulluar në terren është përpunuar, konservuar dhe është bërë përcaktimi taksonomik në laboratorin e zoologjisë të Universitetit “E.Çabej”. Për determinimin e individëve të grumbulluar, deri në lloje, është shfrytëzuar gjithë literatura e paraqitur tek bibliografia [3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10]. Disa prej llojeve të pilivesave janë fotografuar në terren ose pasi është bërë përpunimi i tyre.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Gjatë ekspeditave tona në terren, për grumbullimin e pilivesave (Odonatave), në mjediset e Liqenit të Viroit dhe ujërrjedhësve rreth tij, kemi arritur të koleksionojmë 10 lloje pilivesash që u përkasin 6 familjeve dhe 9 gjinive. Gjatë grumbullimit të materialit

në terren në stacionet 1 e 2 të Liqenit të Viroit u gjet një numër më i madh individësh që preferonin ambiente me ujëra të ndenjura e të cekëta dhe ku bimësia ujore përfaqësohet nga një shumëllojshmëri e konsiderueshme. Si lloje më të pranishme të odonatave në këto dy stacione u takuan *Lestes sponsa* (Hans, 1823) dhe *Sympetrum sanguineum* (Muell, 1764). Në stacionin 3 dhe 6, si stacione me ujëra të ndenjura e të thella dhe me bimësi më të zhvilluar se në stacionet 1 e 2, janë gjetur më pak numër individësh të këtij grupi. Ndër llojet e takuara në këto stacione kemi: *Brachytron pratense* (Muell, 1764), *Anax imperator* (Leach, 1815), *Cordulegaster annulatus* (Latr.), *Somatochlora metallica* (Vanderlin, 1825), *Libellula depressa* (Linneo, 1758), *Orthretum cancellatum* (Linneo, 1758).

Në stacionin 4, me ujëra të rrjedhshëm dhe bimësi ujore të konsiderueshme, kemi takuar një numër më të vogël odonatash të përfaqësuara me llojet: *Calopteryx virgo* (Linneo, 1758), *Calopteryx splendens* (Harris, 1782). Në stacionin 5, në zonën e grykëderdhjes së liqenit kemi takuar të gjitha grupet llojore të takuara në stacionet e mësipërme. Për 44 ditë ekspedita, numri i individëve të grumbulluar sipas llojeve në gjashtë stacionet e sipër përmendura paraqitet në tabelën 1.

Lista e llojeve të gjetura	Numri i llojeve
<i>Lestes sponsa</i> (Hans, 1823)	92
<i>Sympetrum sanguineum</i> (Muell, 1764)	102
<i>Brachytron pratense</i> (Muell, 1764)	9
<i>Anax imperator</i> (Leach, 1815)	10
<i>Cordulegaster annulatus</i> (Latr.)	12
<i>Somatochlora metallica</i> (Vanderlin, 1825)	18
<i>Libellula depressa</i> (Linneo, 1758)	13
<i>Orthretum cancellatum</i> (Linneo, 1758)	15
<i>Calopteryx virgo</i> (Linneo, 1758)	33
<i>Calopteryx splendens</i> (Harris, 1782).	21

Tabela 1. Lista e llojeve të odonatave me numrin përkatës të grumbulluar

Llojet e takuara në këto habitate janë listuar këtu më poshtë së bashku me pozicionin e tyre sistematik:

Mbretëria e Kafshëve

Tipi Arthropoda.

N/Tipi Mandibulata

M/Klasa Hexapoda (Insects)

Klasa Insecta Pterygota

N/Klasa Paleoptera

Mb/rendi Anfibiotici (Odonatapteri).

Rendi Odonata

N/Rendi Zigoptera



Figura 1 *Lestes sponsa*

1- Familja Lestidae

Gjinia *Lestes*

me llojin: - *Lestes sponsa* (Hans, 1823) (fig.1).

2 – Familja Calopterygidae

Gjinia *Calopteryx*

me llojet: - *Calopteryx virgo* (Linneo,1758)

- *Calopteryx splendens* (Harris, 1782)

N/Rendi Anisoptera

1- Familja Aeshnidae

Gjinia *Brachytron*

me llojin: -*Brachytron pratense* (Muell, 1764)

Gjinia *Anax*

me llojin - *Anax imperator* (Leach, 1815)

2 – Familja Cordulegasteridae

Gjinia *Cordulegaster*.

me llojin: - *Cordulegaster annulatus* (Latr.)

3 – Familja Corduliidae

Gjinia *Somatochlora*

me llojin - *Somatochlora metallica* (Vanderlin, 1825)

4 – Familja Libellulidae

Gjinia *Libellula*

me llojin: - *Libellula depressa* (Linneo, 1758)

Gjinia *Orthretum*

me llojin: - *Orthretum cancellatum* (Linneo,1758)

(fig.3)

Gjinia *Sympetrum*

me llojin - *Sympetrum sanguineum* (Muell, 1764)

Një pjesë e këtyre përfaqësuesve janë të ilustruar në këtë material me fotot e realizuara nga ne e të konsideruara si më cilësore.

Nga punimi rezulton se në habitatet e marra në analizë evidentimi i 10 llojeve të pilivesave (Odonatave) përbën një të dhënë të plotë për herë të parë mbi këtë grup insektesh për zonën në fjalë në veçanti dhe një plotësim të mëtejshëm për punimet mbi këtë grup

insektesh në rang vendi. Ky grup insektesh përfaqësohet nga forma të dobishme, me jetë-dite, të ambienteve të lagështa. Vlera kryesore e këtij punimi qëndron në identifikimin për herë të parë të llojeve të grupit në fjalë në këtë zonë të rajonit të Gjirokastrës.



Figura 2 *Libellula depressa*



Figura 3 *Orthretum cancellatum*



Figura 4 *Stacionet në liqenin e Viroit*

Mendojmë se vazhdimi i punës në këtë drejtim mund të çojë në pasurimin llojor të këtij grupi në këtë ekosistem apo dhe në rishqyrtimin e ndonjë prej llojeve të takuara, kjo për faktin e ngjashmërive të larta ndërlojore si dhe variacioneve të larta të homokromisë në funksion të seksit dhe mjedisit.

Gjatë dy periudhave studimore, të përmendura më lartë, me një diferencë kohore 5 vjeçare ne nuk patëm ndonjë ndryshim në përbërjen llojore të këtij rendi. Një gjë e tillë vetëm rikonfirmoi rezultatet e mëparshme në këtë drejtim.

Me këtë punim plotësohet më tej sasia llojore e biodeversitetit të zonës së Viroit duke e rritur në 72 përbërjen llojore të botës shtazore invertebrore dhe në 380 përbërjen totale llojore të tij të njohur deri më tani.

BIBLIOGRAFIA

1. Avjerincjev S.V. (1952) "Zoologjia bjespozvonoçnih Sovjetskaja nauka. Moskva"
2. Chinery M. (1993) (2004) "Guida degli insetii", London, Roma
3. Dogjel, V.A. (Ezhikov I.I.). (1951) "Rukovodstvo zoologii tom I,II,III Sovjetckaja nauka Moskva"
4. Gjikhuri L. (1994) "Zoologjia e parruazorëve", Tiranë
5. Jacques d`A., Jean-L. D., Rene` P. (1990) "Guida delle libellule d`Europa e del Nord Africa", Italy
6. Kolosi G. (1956) "Zoologjia, biologia generale", Volume secondo, Torino.
7. Lamani. F. (1981) "Teknika e përgatitjes së koleksioneve zoologjike", Tiranë
8. McGavin G.C. (2000) "Insetii, Ragni e altri artropodi Terrestri", London, Milano
9. Misja. K. (1983) "Përcaktues insektesh", Pjesa I,III, Tiranë
10. Misja. K., Hasani L. (1989) "Udhëzues për praktikën verore, Klasa e kandrrave (insecta)", Tiranë
11. Misja.K. (1974) "Përcaktues insektesh", Pjesa II, Tiranë
12. Shvaniç B.N. (1949) "Kurs obsheje, entomologii", Moskva
13. Vili, Botim i përkthyer (1982) "Biologjia e Vilit", Pjesa I-rë